



## EUROPEAN UNION ELECTION OBSERVATION MISSION

KOSOVO\* PARLIAMENTARY ELECTIONS  
9 February 2025

### Deklaratë për media

## Shefja e Misionit Nathalie Loiseau nis zyrtarisht Misionin e BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve dhe nënvizon mbështetjen e BE-së për Kosovën për të fuqizuar më tej qeverisjen demokratike

**Prishtinë, 18 janar 2025** – Shefja e misionit të Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EU EOM) në Kosovë, Nathalie Loiseau, anëtare e Parlamentit Evropian, nisi zyrtarisht misionin sot gjatë një konference për media në Prishtinë. Shefja e misionit Loiseau njoftoi se, pas ftesës nga Presidentja e Kosovës drejtuar BE-së për të vëzhguar zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, misioni do të shpërndajë në terren 18 vëzhgues afatgjatë të zgjedhjeve për t'i mbuluar të gjitha komunat e Kosovës. Ekipi bazë i misionit prej nëntë analistësh filloi punën në fillim të këtij muaji kur arriti në Prishtinë më 8 janar.

**Shefja e misionit Nathalie Loiseau tha:** “Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 janë moment me rëndësi për Kosovën, duke shfaqur pluralitetin e peizazhit politik të Kosovës. Prania e Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve nga BE në terren synon të kontribuojë në një proces zgjedhor gjithëpërfshirës, të besueshëm dhe transparent, duke u lejuar votuesve të Kosovës të shprehin zgjedhjet e tyre. Kjo gjithashtu nënvizon mbështetjen e vazhdueshme të BE-së për Kosovën për të fuqizuar më tej qeverisjen demokratike.”

Shefja e misionit në vazhdim tha: “Po i shpërndajmë në terren nëntë ekipe të vëzhguesve afatgjatë, që punojnë në çifte, meshkuj dhe femra, në mbarë Kosovën. Ata do të vlerësojnë fushatën dhe përgatitjet për zgjedhje në të gjitha komunat. Vëzhguesit afatgjatë janë të rëndësishëm për misionin për vëzhgimin e zgjedhjeve të BE-së për të kryer një vlerësim të plotë dhe gjithëpërfshirës të procesit zgjedhor, në përputhje me metodologjinë standarde të BE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve.”

Vëzhguesit afatgjatë vijnë nga 18 shtete, përfshirë Shtetet Anëtare të BE-së, Norvegjinë dhe Zvicrën. Janë vëzhgues të pavarur dhe të paanshëm dhe do të takojnë zyrtarë lokalë të zgjedhjeve, kandidatë dhe përfaqësues të partive politike, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe mediave lokale.

Pak para ditës së zgjedhjeve, misioni do të përforcohet me 36 vëzhgues afatshkurtër, një delegacion deputetësh nga Parlamenti Evropian dhe deri në 36 diplomatë nga shtetet anëtare të BE-së, Kanada, Norvegjia dhe Zvicra, të akredituar në Kosovë, në mënyrë që të sigurohet mbulim sa më i gjerë për Kosovën. Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve nga BE do të qëndrojë në Kosovë deri në përfundim të procesit zgjedhor.

EU EOM operon nën një kod sjelljeje i cili kërkon neutralitet të rreptë dhe mosndërrhyrje. Misioni operon nën një mandat të veçantë dhe të dallueshëm nga ai i Komisionit Evropian dhe institucioneve të tjera të BE-së në Kosovë. Misioni funksionon në përputhje me [Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve \(verzioni në gjuhën angleze\)](#).

Vëzhguesit afatgjatë do të nisen në terren të dielën më 19 janar në orën 10:00 nga selia e Misionit në Prishtinë. Përfaqësuesit e mediave janë të mirëpritur ta përcjellin ngjarjen.

EU EOM do të nxjerrë gjetjet preliminare në një konferencë për media, dy ditë pas ditës së zgjedhjeve.

### Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni:

Emilia Hinkkanen, Zyrtare për Media, EU Election Observation Mission Kosovo 2025

[emilia.hinkkanen@eueomkosovo2025.eu](mailto:emilia.hinkkanen@eueomkosovo2025.eu)

+383 45 536 911

\*This designation is without prejudice to positions on status and is in line with UNSCR 1244/1999 and the ICJ Opinion on the Kosovo declaration of independence.